REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/br. 889/20
Date/Datum. 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.889/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "A&V Collection" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.T.SH "ALBKOS INT"- lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma të zjarrfikës për nevojat e FSK-së", me nr. të prokurimit: 217-20-2753-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- "Ministria e Mbrojtjes", më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "A&V Collection" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma të zjarrfikës për nevojat e FSK-së", me numër të prokurimit: 217-20-2753-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- "Ministria e Mbrojtjes".

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma të zjarrfikës për nevojat e FSK-së", me numër të prokurimit: 217-20-2753-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- "Ministria e Mbrojtjes", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "A&V Collection" - Prishtinë, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "A&V Collection"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.11.2020 me nr. 889/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma të zjarrfikës për nevojat e FSK-së", me numër të prokurimit: 217-20-2753-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- "Ministria e Mbrojtjes"/MM/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 28, 60, 59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr. 889/20 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së sa i përket referencave për tri vitet e fundit për kontrata të njëjta apo të ngjashme.

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, tek follderi i titulluar "referencat.pdf", kemi hasur në një lsitë kontratave, ku OE ka shënuar rreth 20 kontrata.

Në të njëjtin folder pas listës OE ka bashkangjitur edhe tri referenca.

Referenca e parë me Policinë e Kosovës në vlerë 12,305.528.17, e cila është referencë për kontratë kornizë të vitin 2014 e përfunduar në 2017, mirëpo është lëshuar në emër të grupit të OE-ve ku kompania Albkos duket të jetë anëtar i dytë i grupit, dhe nuk dihet se sa është vlera e realizuar nga kompania Albkos dhe sa është realizuar nga lideri.

Referenca e dytë e lëshuar nga Neë Co Ferronikeli Complex L.L.C është për vitet 2015, 2016 dhe 2017,

ku për vitin 2017 thuhet se OE ka bërë fumizime në vlerë 63,216.00€, andaj vlerësojmë se vetëm realizimi gjatë vitit 2017 mund të jetë i pranueshëm.

Referenca e tretë është lëshuar nga MPB mirëpo nuk dihet se sa është vlera e kontratës dhe nuk dihet

Me gjithë se sipas RRUOPP-se në rast të mungesave të referencave/certifikatave te pranimit, për kontrata te cilat gjenden ne liste te ofruar nga OE mund të kërkohet sqarim, ne platformen e E Prokurimit nuk kemi has ne deshmi tjera/shtesë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën e Ak-së :

"Kërkesa 08 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 150,000.00 €;"

Përgjigje në pretendimin nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë i bërë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë është se i njëjti mostrën e ofruar pranë AK-së nuk e ka në përputhje me specifikat teknike të dosjes së tenderit.

OE ankues pretendon se mostra e OE të rekomanduar për kontratë nuk e k atë qepur fare patentin/zingjirin e jaknes.

Duhet theksuar se në dosje të tenderit lidhur me mostra kërkesa decidive ka qenë sinë vijim:

"Evidenca 10 Dëshmi te gjitha mostrat e artikujve te kërkuar duhet te dorëzohen te paketuara . Vërejtje Mospërputhja e mostrave sipas kërkesave te dhëna ne DT Aneksi 1, do te ketë për pasoj eliminimin e ofertës tuaj."

Duke pas parasysh rrethanat e krijuara për shkak të COVID 19, rekomandojmë që gjatë procedurës së rivlerësimit AK të analizoj dhe vlerësoj nëse mostra e OE të rekomanduar për kontratë është në pajtim me kërkesat e dosjes/specifikat teknike.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin e OE ankues se katalogjet e tij janë larguar nga ana e AK-së eksperti shqyrtues nuk mund të jap përgjigje, mirëpo duhet te theksojmë se në raportin paraprak nr.565/20 eksperti ka pas qasje në oferten OE :"A&V Collection" me te cilin rast kemi vlerësuar se kane munguar katalogje për nenkapele dhe doreza. Me gjithë se sipas RRUOPP-së ashtu siç pretendon OE ankues për katalogje mund të kërkohet sqarim/plotësim shtesë, përmes raportit 565/20 kemi vlerësuar se OE AV Collection po ashtu ka ofruar produkte te cilat nuk janë ne pajtim me disa specifika teknike te kërkuara ne dosje te tenderit si ngjyra e dorezave, trashësia lëkurës te çizmeve, mungesa informatës për peshën e çizmeve etj. Të gjitha këto arsye gjenden te detajuara ne raportin e ekspertizës nr.565/20 te cilën OE ankues mund ta gjej te ngarkuar ne faqe zyrtare te OSHP-se.

Përgjigje në pretendimin nr.4

Pretendimi tjetër ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë është se i njëjti nuk ka plotësuar specifikat teknike te gjepat detajet e jakës, te xhepit te dorës e te gjitha këto shirita ngjitës, më konkretisht pretendimi ankimorë është si në vijim:

"Pretendimi ynë 6 është se OE Albkos INT nuk i ka plotësuar pikat 1.2.5 e specifikimit teknik te gjepat detajet e jakës, te xhepit te dorës e te gjitha këto shirita ngjitës nuk janë plotësuar sipas specifikimit teknik. " Siç shihet nga pretendimi ankimorë i shënuar më lart OE ankues nuk ofron informata se çka konkretisht nuk është në pajtim me specifikat teknike, a janë dimensionet e gjepave, materiali, dizajni apo çfarëdo informate tjetër për të bërë krahasim me kërkesat e dosjes, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i mangët dhe si i tillë vlerësojmë se është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka pergjigje

Operatori Ekonomik, me datë: 19.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "A&V Collection" – Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së sa i përket referencave për tri vitet e fundit për kontrata të njëjta apo të ngjashme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, tek follderi i titulluar "referencat.pdf", kemi hasur në një listë të kontratave, ku OE ka shënuar rreth 20 kontrata. Në të njëjtin folder pas listës OE ka bashkangjitur edhe tri referenca.

Referenca e parë me Policinë e Kosovës në vlerë 12,305.528.17, e cila është referencë për kontratë kornizë të vitin 2014 e përfunduar në 2017, mirëpo është lëshuar në emër të grupit të OE-ve ku kompania Albkos duket

të jetë anëtar i dytë i grupit, dhe nuk dihet se sa është vlera e realizuar nga kompania Albkos dhe sa është realizuar nga lideri.

Referenca e dytë e lëshuar nga New Co Ferronikeli Complex L.L.C është për vitet 2015, 2016 dhe 2017, ku për vitin 2017 thuhet se OE ka bërë fumizime në vlerë 63,216.00€, andaj vlerësojmë se vetëm realizimi gjatë vitit 2017 mund të jetë i pranueshëm. Referenca e tretë është lëshuar nga MPB mirëpo nuk dihet se sa është vlera e kontratës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas RRUOPP-se në rast të mungesave të referencave/certifikatave te pranimit, për kontrata të cilat gjenden ne liste të ofruar nga OE mund te kërkohet sqarim, ne platformën e E-Prokurimit nuk kemi has ne dëshmi tjera/shtesë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së :"Kërkesa 08 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 150,000.00 €;"

Lidhur me pretendimin e OE ankues "A&V Collection" – Prishtinë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë është se i njëjti mostrën e ofruar pranë AK-së nuk e ka në përputhje me specifikat teknike të dosjes së tenderit. Më, tej OE ankues pretendon se mostra e OE të rekomanduar për kontratë nuk e ka atë qepur fare patentin/zingjirin e jaknes. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit lidhur me mostra kërkesa decidive ka qenë si në vijim:

"Evidenca 10 Dëshmi të gjitha mostrat e artikujve te kërkuar duhet te dorëzohen te paketuara Vërejtje Mospërputhja e mostrave sipas kërkesave te dhëna ne DT Aneksi 1, do te ketë për pasoj eliminimin e ofertës tuaj." Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pas parasysh rrethanat e krijuara për shkak të COVID 19, rekomandon që gjatë procedurës së rivlerësimit AK të analizoj dhe vlerësoj nëse mostra e OE të rekomanduar për kontratë është në pajtim me kërkesat e dosjes/specifikat teknike.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "A&V Collection" – Prishtinë se katalogjet e tij janë larguar nga ana e AK-së .Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron nuk mund të jap përgjigje, mirëpo duhet te theksojmë se në raportin paraprak nr.565/20 eksperti ka pas qasje në ofertën OE: "A&V Collection" me te cilin rast ka vlerësuar se kane munguar katalogje për nenkapele dhe doreza. Me gjithë se sipas RRUOPP-së ashtu siç pretendon OE ankues për katalogje mund të kërkohet sqarim/plotësim shtesë, përmes raportit 565/20 kemi vlerësuar se OE "AV Collection" po ashtu ka ofruar produkte te cilat nuk janë në pajtim me disa specifika teknike të kërkuara ne dosje të tenderit si ngjyra e dorezave, trashësia lëkurës te çizmeve, mungesa informatës për peshën e çizmeve etj. Të gjitha këto arsye gjenden te detajuara ne raportin e ekspertizës nr.565/20 të cilën OE ankues mund ta gjej te ngarkuar ne faqe zyrtare te OSHP-se.

Lidhur me pretendimet tjera ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë është se i njëjti nuk ka plotësuar specifikat teknike te gjepat detajet e jakës, te xhepit të dorës e të gjitha këto shirita ngjitës, më konkretisht pretendimi ankimorë është si në vijim: "Pretendimi ynë 6 është se OE Albkos INT nuk i ka plotësuar pikat 1.2.5 e specifikimit teknik te gjepat detajet e jakës, te xhepit te dorës e te gjitha këto shirita ngjitës nuk janë plotësuar sipas specifikimit teknik". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se siç shihet nga pretendimi ankimorë i shënuar më lart OE ankues nuk ofron informata se çka konkretisht nuk është në pajtim me specifikat teknike, a janë dimensionet e gjepave, materiali, dizajni apo çfarëdo informate tjetër për të bërë krahasim me kërkesat e dosjes, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i mangët dhe si i tillë është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin sipas kërkesës së dosjes së tenderit .Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Ministria e Mbrojtjes

1x1 OE "A&V COLLECTION"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.